

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomik
Rishikim i gjendjes aktuale

mars, 2025

Treguesit më të rinj makroekonomik

Rishikim i gjendjes aktuale - ndikimet mbi politikën monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të sigurojë një pasqyrë të të dhënave të fundit makroekonomike (dhjetor 2024 - shkurt 2025) dhe krahasim me parashikimet e fundit makroekonomike (tetor 2024). Me këtë do të përcaktohet se si gjendja aktuale në ekonomi korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të parashikimeve. Rishikimi fokusohet në ndryshimet në supozimet e jashtme dhe në ecurinë e variablave të brendshëm dhe se si këto ndryshime reflektojnë në mjedisin për udhëheqjen e politikës monetare.

Pritjet e fundit për ekonominë globale në periudhën 2025-2026 vazhdojnë të tregojnë rritje të qëndrueshme të saj, dhe rreziqet për rritjen janë kryesisht në rënie. Ato kryesisht kanë të bëjnë me përshkallëzimin e tensioneve gjeopolitike dhe pasigurinë e politikave tregtare, me efektet potenciale edhe mbi inflacionin, të cilat mund të ngadalësojnë procesin e nisur të lehtësimit monetar me një ndikim negativ në qëndrueshmërinë fiskale dhe financiare, si dhe lidhen gjithashtu edhe me rritjen e mundshme më të dobët të ekonomive më të mëdha dhe ndryshimet klimatike. Përkundër kësaj, procesi më i shpejtë i dezinflacionit, lehtësimi i mëtejshëm më i fortë i politikës monetare dhe i kushteve financiare dhe rritja më e fortë se sa pritej në ekonomitë më të mëdha mund të kontribuojnë në rritje më të lartë globale.

Duke parë përmes treguesve të veçantë sasior për rrethin e jashtëm të rëndësishëm për ekonominë maqedonase, vlerësimi për rritjen e kërkesës së huaj efektive është korigjuar në rënie në krahasim me muajin tetor për të gjithë periudhën e parashikimeve, ndërsa për inflacionin e jashtëm efektiv, ecuria për vitin 2024 dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme janë të ngjashme me ato të tetorit. Për sa i përket kursit të këmbimit, projeksionet e fundit tregojnë për një vlerë më të lartë të dollarit amerikan ndaj euros në periudhën 2025-2026 krahasuar me muajin tetor. Te **çmimet botërore të produkteve primare** janë bërë rishikime në drejtime të ndryshme, nga ku në vitin 2025 çmimet e naftës, bakrit dhe në veçanti misrit janë korigjuar në rritje, dhe për vitin 2026 kryesisht në rënie. Nga ana tjetër, korigjimet te çmimet e nikelit dhe grurit për vitin 2025 janë në rënie, ndërsa për vitin 2026 janë në rritje. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e produkteve primare janë nën ndikim të madh të ngjarjeve gjeopolitike, që sollën pasiguri të mëdha rreth dinamikave të tyre të ardhshme dhe efekteve mbi ekonominë globale dhe vendase.

Në raport me **normën e huaj të intersit EURIBOR** me maturim një mujor, parashikimet më të reja për vitin 2025 dhe 2026 janë të rishikuara pak më poshtë, në pajtim me pritshmëritë për ulje të normave të interesit të BQE-së në periudhën e ardhshme, pak më shpejtë nga pritshmëritë e mëparshme. Këto pritshmëri konfirmohen edhe nga vendimi i BQE-së në muajin mars për uljen e mëtejshme të normave të interesit me 0,25 p.p., në kushtet kur procesi i dezinflacionit është në pajtim me pritshmëritë, por ekonomia vijon të përballet me sfida, të cilat rrjedhin pjesërisht nga pasiguria e lartë që rrethon politikën tregtare. Nga këtu, edhe pritshmëritë e BQE-së për rritjen ekonomike janë rishikuar pak më poshtë në krahasim me parashikimet e dhjetorit të vitit 2024, nga ku për vitin 2025 pritet rritje prej 0,9% nga ku pritet përsheptim gradual i rritjes së normave prej 1,2% dhe 1,3% në vitin 2026 dhe 2027, përkatësisht¹. Te parashikimi i inflacionit, vlerësimi për vitin 2025 është rishikuar lehtësisht në rritje krahasuar me dhjetorin 2024 dhe pritet të jetë 2,3%, dhe më pas të ulet në 1,9% në vitin 2026 dhe përkatësisht, 2% në 2027, ngjashëm me dhjetorin².

¹Në parashikimet e dhjetorit, u parashikuan norma në rritje të PBB-së prej 1,1% në vitin 2025, 1,4% dhe 1,3% në vitin 2026 dhe 2027, përkatësisht.

²Në dhjetor ishin parashikuar norma të inflacionit prej 2,1%, 1,9% dhe 2,1% në vitin 2025, 2026 dhe 2027, respektivisht.

Treguesit më të rinj nga ekonomia vendase flasin për një pasqyrë makroekonomike e cila në masë të madhe është në pajtim me pritjet nga parashikimet e tetorit, me devijime të vogla në segmente të caktuara. Në tremujorin e fundit të vitit 2024 **rritja reale e PBB-së edhe më tej përshpejtohet, duke arritur normën prej 3,2%** (rritje prej 3,0% në tremujorin paraprak), me rritje të mëtejshme në bazë tremujore (sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së). Norma e realizuar është pothuajse e njëjtë me vlerësimin për rritje vjetore në tremujorin e katërt nga tetori. E analizuar sipas komponentëve, rritja vjetore vjen nga kërkesa e brendshme, me rritje në të tri kategoritë, ndërkohë që eksportet neto kanë kontribuar negativisht, me rënie të eksporteve dhe rritje të importeve të mallrave dhe shërbimeve. **Për gjithë vitin 2024, është realizuar rritje reale e PBB-së nga 2,8% dhe është më e lartë nga parashikimet e ciklit të parashikimeve të tetorit (2,3%³).** Të dhënat me frekencë të lartë për tremujorin e parë të vitit 2025 me të cilat disponon për momentin janë të kufizuara. Të dhënat e deritanishme të janarit tregojnë për një rritje të lehtë të prodhimit industrial, ndërkohë që qarkullimi i përgjithshëm tregtar ka shënuar rënie të lehtë reale. **Norma vjetore e inflacionit në muajin shkurt** rezultoi 5% dhe mbeti në të njëjtin nivel me një muaj më parë (4,9%), e ndikuar nga baza më e ulët krahasuese nga e njëjta periudhë e një viti më parë, kur ishin në fuqi masat për zbutjen e rritjes së çmimeve. Nga pikëpamja strukturore, rritja e çmimeve vjen nga ushqimet dhe komponentët bazë, ndërkohë që çmimet e energjentëve kanë shënuar rënie të lehtë. **Pritjet e konsumatorëve** të paraqitura në anketimet e janarit tregojnë për ulje më të theksuar të çmimeve në periudhën e ardhshme. **Diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë** në janar u stabilizua. Rishikimet e çmimeve të importit janë kryesisht në rritje, megjithëse pasiguria për dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike është ende e pranishme.

Rezervat valutore në fund të shkurtit të vitit 2025 shënojnë 4.861,3 milionë euro. **Analiza e treguesve të përshtatshmërisë së rezervave valutore tregon se ato edhe më tej mbahen në zonën e sigurt.** Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në janar të vitit 2025 tregojnë për një deficit tregtar për tremujorin e parë të vitit që është disi më i lartë se sa pritej në pajtim me parashikimin e tetorit, edhe pse periudha është shumë e shkurtër për vlerësim më të saktë. Të dhënat për veprimtarinë e këmbimit përfshirë muajin shkurt 2025, tregojnë për të hyra neto nga transferimet private të cilat janë disi më të ulëta se sa pritej për tremujorin e parë në pajtim me parashikimin e tetorit. Deficiti i realizuar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në tremujorin e katërt të vitit 2024 është pak më e lartë se sa pritej sipas parashikimit të tetorit, gjithashtu me flukse hyrëse financiare neto më të larta se sa pritej.

Lidhur me **lëvizjet e sektorit monetar, depozitat** totale në janar 2025 janë më të larta për 10,0% në bazë vjetore, me një rritje të parashikuar për tremujorin e parë prej 8,0% sipas parashikimit të tetorit. **Totali kredive** në sektorin privat në janar të vitit 2025 shënon rritje prej 11,3% me rritje të parashikuar vjetore për tremujorin e parë prej 7,5% sipas parashikimit të tetorit. Rritja e kredive të reja po ngadalësohet që nga janari 2025, për shkak të rritjes më të ngadaltë të ndërmarrjeve. Konkretisht, shuma e totalit të kredive të reja të miratuara në sektorin privat në 12 muajt e fundit, përfshirë edhe janarin e vitit 2025, mesatarisht shënoi rritje të ngadaltë në bazë vjetore.


Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në janar 2025 është arritur deficit prej 2.706 milionë denarë, ose 6,5% të deficitit të planifikuar për vitin 2025. Deficiti buxhetor financohet nga huamarrja neto e shtetit në tregun e brendshëm dhe nga konsumi i vogël i depozitave, me zhvlerësim neto në tregun e huaj.

Zhvillimet kryesore të treguesve makroekonomik janë kryesisht në pajtim me pritjet e parashikimeve të fundit. Në kushtet e një baze më të ulët krahasuese, si dhe me rritje

³Rritja më e lartë e arritur për gjithë vitin 2024 është pjesërisht si pasojë e rishikimeve në rritje të të dhënave për tremujorin e parë dhe të dytë 2024 në njoftimin e PBB-së së dhjetorit 2024 nga ESHS-ja, pra pas përfundimit të ciklit të parashikimit makroekonomik të Bankës Popullore.

të mëtejshme të çmimeve në baza mujore, norma vjetore e inflacionit në muajin shkurt mbeti në të njëjtin nivel si në muajin paraprak. Pritjet për çmimet e importit në periudhën në vijim janë rishikuar në masë të madhe në rritje krahasuar me ato të parashikimeve të tetorit. Nga ana tjetër, sondazhet e shkurtit nga Komisioni European tregojnë pritshmëritë e konsumatorëve për ulje më të mëdha të çmimeve në 12 muajt e ardhshëm. Të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për tremujorin e parë të 2025 janë aktualisht të kufizuara, të dhënat e janarit që tregojnë rritje të lehtë të prodhimit industrial, ndërkohë që qarkullimi i përgjithshëm tregtar regjistroi rënie të vogël reale. Tregu valutor edhe më tej është stabil, ndërsa ndryshimi të rezervat valutore në përgjithësi është afër pritshmërive. Njëkohësisht, ecuria e depozitave dhe e kredisë në janar 2025 ishte më e mirë se pritjet për tremujorin e parë.

Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kërkesa e huaj është rishikuar në rënie për të gjithë periudhën e parashikimit....

...kryesisht për shkak të vlerësimeve për rritje më të ulët të ekonomisë gjermane⁴.

Inflacioni i huaj efektiv (ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Në vitin 2024 **inflacioni efektiv i huaj** shënoi rritje prej 3,1%, i ngjashëm me atë që pritej nga tetori...

...ndërsa të ngjashme me parashikimet e tetorit janë edhe vlerësimet për vitin 2025 dhe 2026, nga ku edhe më tej pritet ngadalësimi i tij gradual.

Kursi euro/USD-dollar



Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.


Vlerësimet e reja për **kursin valutor euro-dollar amerikan** tregojnë për forcim të vlerës së dollarit amerikan në raport me euron në periudhën e ardhshme...

...ndërsa aktualisht parashikohet një mbivlerësim i dollarit amerikan për vitin 2025, në vend të nënvlerësimit, dhe një nënvlerësim më i vogël i tij në vitin e ardhshëm sesa ishte parashikuar në tetor.

⁴Rënia e parashikuar e Gjermanisë prej 0,3% në vitin 2024 dhe rritje prej 0,3% dhe 0,9% në 2025 dhe 2026, respektivisht, kundrejt vlerësimeve të rritjes prej 0%, 1% dhe 1,3% në tetor.

Nafta "brent"

(mesatarja tremujore, euro/fuçi)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Vlerësimet e fundit për çmimet e produkteve primare të shprehura në euro për periudhën 2025-2026 tregojnë rishikime divergjente.

Konkretisht, në vitin 2025 kemi rishikime në rritje të çmimeve të naftës, bakrit dhe veçanërisht misrit, ndërsa në çmimet e nikelit dhe grurit korrigjimet janë në rënie krahasuar me muajin tetor...


...si rezultat i diferencave të kursit (mbivlerësimi i dollarit amerikan) të nafta dhe bakri dhe furnizimet e ulëta të misri...

...dhe në nivel më të lartë të prodhimit dhe furnizimit me grurë dhe nikel.

Në vitin 2026, krahasuar me parashikimet e tetorit, pritet rënie më e madhe e çmimit të naftës, rënie minimale në vend të rritjes të misri, rritje më e fuqishme të çmimit të grurit dhe nikelit.

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro


(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Euribor-i njëmuor
(mesatarja tremujore, në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Tek **EURIBOR-i njëmuor** janë kryer korrigjime të vogla në rënie për vitin 2025 dhe 2026...

...në pajtim me pritshmëritë për ulje pak më të shpejtë të normave të interesit nga ana e BQE-së nga pritshmëritë paraprake të tetorit, në linjën dhe në pritshmëritë e përkeqësuar për aktivitetin ekonomik në Eurozonë.

Indeksi i stresit financiar




Burimi: "Zyra për Hulumtime Financiare në kuadër të Këshillit për mbikëqyrje të stabilitetit financiar të SHBA'së".

Treguesi për stresin global financiar⁵ vazhdon të tregojë luhatshmëri të ulët në tregjet financiare.

⁵ Tregues KFI IFS (ang. OFR, FSI) e mat stresin sistematik financiar - çrregullime në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 tregues të ndryshueshëm të tregut financiar, të mbledhur në pesë kategori treguesish: Kredi, vlerësim të kapitalit, financim, fonde të sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëri. Vlera e treguesit, në ditë të caktuar paraqet nivel mesatar të ponderuar të çdo ndryshim të shënuar atë ditë, lidhur me vlerën e tij historike, ku treguesi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e inflacionit


(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë

(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Në shkurt 2025, çmimet e brendshme të konsumit shënuan rritje të lehtë prej 0,5% në bazë mujore (0,2% në janar) kryesisht shkak i rritjes së çmimeve të ushqimeve.

Produktet ushqimore shënuan rritje mujore të çmimeve prej 1,4%⁶ (të pandryshueshme në janar), me rritje të theksuar te të gjithë kategoritë e çmimeve, dhe më së shumti për shkak të rritjes së çmimeve të mishit dhe kategorive "bukë dhe drithëra" dhe "qumësht, djathë dhe vezë".

Çmimet e energjentëve shënuan rritje prej 0,5%, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të derivateve të naftës dhe në rritjen e rregulluar të çmimit të energjisë termike⁷.


Nga ana tjetër, inflacioni bazë në bazë mujore shënoi rënie prej 0,2%, e cila vjen si pasojë e uljes së çmimeve të trafikut ajror, kryesisht nën ndikim të faktorëve sezonal.

Norma vjetore e inflacionit në shkurt shënon 5,0% dhe u mbajt në nivel të ngjashëm sikur në janar (4,9%). Rritja e çmimeve vjen nga ushqimet dhe komponentët bazë, ndërsa çmimet e energjisë kanë shënuar rënie të lehtë. Niveli i normës së inflacionit në këtë periudhë është ndikuar edhe nga baza më e ulët krahasuese nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, si pasojë e masave që ishin vendosur në atë kohë për të kufizuar përkohësisht rritjen e çmimeve.

⁶Në shkurt u mor vendimi për kufizimin e marzhit bruto të fitimit të 102 grupeve të produkteve, ushqimore dhe joushqimore, me vlefshmëri nga 20 shkurti deri në fund të prillit 2025. Marzhet janë kufizuar në 5%, 10% dhe 15%, varësisht prej grupës së produkteve, në pajtim me vendimin (lidhja). Pritet që masa e tillë të ketë efekt më të favorshëm mbi çmimet e ushqimit muajin e ardhshëm për shkak të mënyrës së regjistrimit të çmimeve nga e Entit Shtetëror të Statistikave.

⁷ Në pajtim me vendimin e Komisionit Rregullator të Energjetikës (KRE), në muajin shkurt çmimi për konsumatorët e energjisë për ngrohje në qytetin e Shkupit është rritur për 5,03%, si pasojë e rritjes së çmimit të gazit natyror në bursat botërore.(lidhja).


Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p)



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Diferenca e inflacionit në Eurozonë në janar⁸ është e qëndrueshme, me një përshpejtim minimal si në eurozonë ashtu edhe në inflacionin e brendshëm.


Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë



Burimi: Eurostat.

Pritjet e konsumatorëve⁹ të dhëna në anketimet e shkurtit tregojnë për ulje më të theksuar të çmimeve në periudhën e ardhshme.

Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)




Burimi: Komisioni Evropian.

⁸ Bazuar në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit, për të cilin të dhënat e fundit të publikuara për vendin janë për muajin janar.


⁹ Anketa e Komisionit Europian për optimizmin e konsumatorit nga shkurti 2025, bazuar në pyetjen "pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm"

Parashikimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve për inflacionin në 3 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.


Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimeve dhe pijeve joalkolike (indeks, 2015=100)



* Çmimet e huaja efektive të ushqimeve paraqesin shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: EShS-ja, Eurostat-i dhe llogaritje të BPRMV-së.

Paga mesatare e paguar
(normat vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Lidhur me **sektorin korporativ**¹⁰, në shkurt pritjet e inflacionit në periudhën e ardhshme janë më të ulta në ndërtimtari, tregtinë me pakicë dhe industrinë e përpunimit, derisa në sektorin e shërbimeve janë më të larta krahasuar me janarin.


Rishikimet e lëvizjeve të pritshme në supozimet e jashtme hyrëse te parashikimi i inflacionit për vitin 2025 aktualisht janë kryesisht në drejtim rritës, me rishikim në rritje për çmimet e naftës, misrit dhe në masë më të vogël te inflacioni efektiv i huaj. Njëkohësisht, pasiguria nga dinamika e ardhshme e çmimeve të produkteve primare është ende e lartë.

Në dhjetor 2024, **paga mesatare nominale neto** shënoi një rritje vjetore më të ngadaltë krahasuar me muajin paraardhës...

...me rënie të pagave në ndërtim dhe rritje më të ngadaltë në industri dhe bujqësi dhe rritje relativisht të qëndrueshme të pagave në shërbime...

¹⁰ Anketa për tendencat afariste të Komisionit Evropian në industrinë, tregtinë me pakicë, ndërtimtarinë dhe sektorin e shërbimit.

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve
(normat nominale vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

... ndërsa të ngjashme janë edhe zhvillimet të **paga reale neto**, rritja e së cilës gjithashtu përshpejtoi në këtë periudhë.

Ndryshimi i realizuar nominal dhe real i pagave në tremujorin e katërt të vitit 2024 është pak më i lartë krahasuar me normat e pritshme për tremujorin e katërt në kuadër të parashikimit të tetorit.

Prodhimi i brendshëm bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja dhe parashikime të BPRMV-së.

Të dhënat e parashikuara janë të rregulluara për sezonalitet, por dallimet në seritë për periudhën e realizuar mund të paraqiten edhe si pasojë e rishikimeve të rregullta të EShS-së.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, rritja reale e PBB-së u përshpejtua lehtësisht në 3,2% në bazë vjetore (rritje prej 3% në tremujorin e mëparshëm)...


...dhe është pothuajse e njëjtë me rritjen e parashikuar për këtë tremujor nga cikli i parashikimit të tetorit.

Shikuar nga ana e shpenzimeve të PBB-së, rritja në tremujorin e katërt ka ardhur si pasojë e kontributit pozitiv të të gjithë komponentëve të kërkesës së brendshme. Nga ana tjetër, kontributi në komponentin e eksportit neto është negativ, me rënie të eksporteve dhe rritje të importeve.

Shikuar nga ana e prodhimit të PBB-së, rritja është përgjithësisht e shpërndarë, por në masë të madhe i detyrohet kontributit pozitiv të ndërtimit, si dhe grupit të aktiviteteve "tregti, transport dhe hotelieri". Nga ana tjetër, kontribut i vogël negativ vërehet në industri.

Në bazë tremujore, PBB-ja shënoi rritje reale prej 0,8%¹¹.

¹¹ Sipas të dhënave të rregulluara sezonale dhe kalendarike nga EShS-ja.



Në kushte të shtrirjes së kufizuar të të dhënave të disponueshme, është e vështirë të jepet vlerësim i saktë për gjendjen e përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2025.


Rezultatet e hulumtimit të anketës për periudhën janar-shkurt 2025 tregojnë këndvështrime më të favorshme krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024, ndërsa janë më pak të favorshme krahasuar me tremujorin paraardhës.¹²

Në janar, **prodhimi industrial** shënoi rritje reale në bazë vjetore, përkundër rënies në tremujorin paraprak...

...në tërësi si rezultat i rritjes së industrisë përpunuese, ndërkohë që minierat dhe energjia kanë kontribut të vogël negativ.

Në muajin janar, **qarkullimi i përgjithshëm tregtar** shënoi rënie reale vjetore, pavarësisht rritjes së vogël në tremujorin paraardhës...

...në kushtet e rënies së tregtisë me pakicë dhe tregtisë së automjeteve, ndërsa tregtia me shumicë shënoi rritje të lehtë.



PRODHI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshime reale vjetore në %												
Produkti i brendshëm bruto	2.5	4.0	2.0	2.5	0.2	2.0	2.7	3.1	1.9	2.8	3.0	3.2
Prodhimi industrial	3.5	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.7	0.4	-3.0	-7.1	-2.1	-2.0
Punë ndërtimore të realizuara	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	27.2
Ndërtim i lartë	-26.6	12.4	-10.0	6.2	12.2	-20.0	-9.8	-18.3	-34.0	-5.3	13.2	23.4
Ndërtim i ulët	4.2	-13.4	-26.9	-27.2	10.5	-22.6	-7.2	37.1	31.6	48.6	22.7	33.3
Punë ndërtimore të specializuara	-27.3	-55.3	-21.9	43.5	69.0	10.6	-21.2	11.3	-3.3	98.0	7.0	-27.0
Qarkullimi në tregti - Gjithsej*	9.7	4.0	0.4	-2.7	3.7	-5.2	-6.3	0.2	-3.3	4.0	2.9	0.4
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-0.4
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	11.0	2.4	-1.3	-3.0	3.8	-3.9	-4.4	2.0	-2.6	6.9	4.0	0.8


* Normat reale të rritjes janë përlogaritje nga BPRMV-ja, duke përfshirë normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025 janë të dhëna preliminare. Të dhënat e PBB-së për vitin 2023 janë preliminare, ndërsa për vitet 2024 Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

Treguesit e disponueshëm të **kërkesës agregate** gjithashtu janë në shtrirje të kufizuar relative, që pengon formimin më të saktë të vlerësimit për lëvizjen e komponentëve të veçantë të kërkesës në tremujorin e parë të vitit 2025.

Të dhënat e disponueshme të **konsumit personal** kryesisht lëvizin në drejtim pozitiv...

¹² Ka të bëjë me anketat e kryera nga ana e Komisionit Evropian për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik përfshihet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit të konsumatorëve dhe treguesve të besimit për sektorët e veçantë ekonomik (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Treguesit e lëvizjes së konsumit privat
(normat reale vjetore, në %)




... me rritje vjetore të pensione¹³, kredive për individë, importit të mallrave të konsumit dhe prodhimit vendas të mallrave të konsumit, me përjashtim të tregtisë me pakicë dhe të ardhurave nga TVSH-ja bruto, të cilat janë në rënie.

Lidhur me të dhënat e janarit me frekuencë të lartë për **investimet bruto**, lëvizjet janë në drejtime të ndryshme...

...me rritje të kredisë afatgjatë të korporatave, dhe rënie të regjistruar të investimeve kapitale shtetërore, tatimit të fitimit, importeve të kapitalit qarkullues dhe prodhimit vendas të mallrave kapitale.

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)



Të dhënat për **shkëmbimin e jashtëm tregtar** në janar të vitit 2025 tregojnë në rritje të mundshme të deficitit në raport me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar, me rritje nominale më të lartë të importeve në raport me eksportet e mallrave.

Arritjet buxhetore në pajtim me të dhënat fiskale për janarin e vitit 2025 tregojnë për rritje të mëtijshme, por më të ngadaltë reale vjetore të **konsumit publik** në tremujorin e parë të vitit.

Treguesit kryesor të tregut të punës¹⁴ në tremujorin e katërt të vitit 2024 vazhdojnë të shënojnë zhvillime pozitive në baza vjetore.

Norma e punësimit u rrit me 0,9 p.p. me bazë vjetore dhe arrin në 46,2%, në kushtet e rritjes së numrit të të punësuarve me 1,9%.

Shkalla e papunësisë u ul në 11,9% (një rënie prej 1,1 p.p.), me një rënie të numrit të të papunëve prej 7,9%.

Nga këndvështrimi i ofertës së fuqisë punëtore, numri i popullsisë aktive në tremujorin e fundit u rrit me 0,6%, ndërsa popullsia joaktive u ul me 0,8%.

¹³ Në tetor 2024 është zbatuar rritje lineare e pensione për 2.500 denarë, në vend të korrigjimit të mëparshëm të normës së rritjes gjashtëmujore të kostos së jetesës dhe pagës mesatare. Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, rreth 340.000 pensionistë që fituan të drejtën e sigurimit pensional deri më 31 gusht, janë të përfshirë me rritjen lineare të pensionave. Këto ndryshime ligjore parashikojnë edhe një rritje lineare të pensione nga 2.500 denarë në mars 2025 (me pagesë në prill) Më shumë detaje në këtë [lidhje](#).

¹⁴ Rezultatet nga Anketa e Fuqisë Puntore (AFP) sipas tremujorëve të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të kaluar nga vitet e kaluara, sepse në vitin 2023 është zbatuar Rregullativa e re (BE) nr. 2019/1700 e Parlamentit Europian dhe Këshillit për Statistikë sociale dhe rregullativën përkatëse ekzekutuese të Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për zonën e fuqisë puntore, ndërsa Rregullativa e mëparshme (BE) nr. 577/98 është hequr. Zbatimi i rregullativës së re shkaktoi ndryshime në hulumtimin, duke filluar me ndryshime në dizajnin e pyetësorit, ndryshimin e renditjes së pyetjeve, ndryshime dhe largim të pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në përfshirje dhe definimin e punësisë dhe papunësisë. Për këtë, analiza është bërë vetëm mbi bazën e të dhënave krahasuese nga viti 2023 e tutje.


Deficiti i tregtisë së mallrave me vendet e jashtme në janar 2025 u zgjerua me 8,1% në bazë vjetore, në kushtet e rritjes më intensive të importeve në raport me rritjen e eksporteve të mallrave.

Eksportet e mallrave në janar 2025 u rritën me 5,1% në bazë vjetore, kryesisht për shkak të eksporteve më të larta nga industria e automobilave. Megjithatë, këto ecuri janë aktualisht pak më të dobëta se ato të parashikuara për tremujorin e parë.

Importet e mallrave në janar 2025 u rritën me 6,1% në bazë vjetore, me rritje të importeve të energjisë dhe lëndëve të para për një pjesë të industrisë së automobilave, por edhe rënie të importeve të pajisjeve dhe makinerive. Ecuria e importit është gjithashtu pak më e ulët se sa pritej, me devijime në rënie në importet e pajisjeve dhe makinerive dhe importet e lëndëve të para për një pjesë të industrisë automobilistike, ndërsa në të njëjtën kohë importe më të larta të energjisë.


Deficiti tregtar në janar 2025 është aktualisht më i ulët se sa pritej për tremujorin e parë sipas parashikimit të tetorit, megjithëse periodha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të sakta.

Eksportet sipas komponentëve
(kontributet në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Burimi: BPRMV.

Importet sipas komponentëve
(kontributet në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Burimi: BPRMV.

KREK (kursi real efektiv i këmbimit)
normat vjetore të ndryshimit, në %



Në janar 2025, KREK-u i deflatuar nga kostoja e jetesës shënoi një mbivlerësim prej 1,7% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i KREK-ut i llogaritur nga çmimet e prodhuesve industrialë shënoi një mbivlerësim prej 2,6%...


KREK (kursi real efektiv i këmbimit)
normat vjetore të ndryshimit, në %



... me një mbivlerësim të KKEN-it me 1% (kryesisht për shkak të nënvlerësimit të lirës turke dhe rublas ruse kundrejt denarit), rritje të kostos relative të jetesës dhe çmimeve relative të produkteve industriale.


KREK, pa lëndët e para

normat vjetore të ndryshimit, në %



Në të njëjtin drejtim janë edhe ndryshimet në indeksin e KREK-ut të llogaritura pa produktet primare.

Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)




Në tremujorin e katërt të vitit 2024, llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 291,4 milionë euro, ose 1,9% të PBB-së, që është pak më e lartë se sa pritej me parashikimet e tetorit...

...me një deficit më të lartë në të ardhurat parësore, si dhe një suficit më të ulët në shërbime.

Për gjithë vitin 2024, deficitin e llogarisë rrjedhëse është gjithashtu pak më i lartë se sa pritej në parashikimet e tetorit.


Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)



Burimi: BPRMV.

...me një deficit më të lartë të të ardhurave parësore dhe një suficit më të ulët të shërbimeve, por edhe me një deficit më të ulët të bilancit tregtar.

Komponentët e llogarisë financiare
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, llogaria financiare regjistroi flukse neto hyrëse¹⁵ prej 810,9 milionë euro (ose 5,3% e PBB-së), të cilat janë më të larta se sa pritej sipas pritshmërive të tetorit...

...me hyrje neto më të larta se sa pritej në investime direkte dhe kredi tregtare e paradhënie, si dhe flukse neto hyrëse të realizuara në vend të daljeve neto të planifikuara në kategorinë valutë dhe depozita.

Komponentët e llogarisë financiare
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Në vitin 2024, llogaria financiare ka arritur flukse neto më të larta se sa pritej, në kushtet e devijimeve pozitive në investimet direkte dhe në valuta e depozita.

¹⁵Sipas metodologjisë së re për përgatitjen e bilancit të pagesave (BPM6), terminet të hyra neto dhe të dala neto shënojnë krijimin e detyrimit neto dhe fitim neto të mjeteve, respektivisht.

Lëvizjet e tregut të këmbimit




*Të dhënat e fundit të disponueshme:
28.02.2025

Burimi: BPRMV.

Oferta e valutave (ndryshime vjetore, %) - boshti i djathtë

Kërkesa e valutave (ndryshime vjetore, %) - boshti i djathtë


Blerja neto në tregun e këmbimit valutor e realizuar në periudhën janar-shkurt 2025 arriti në 204,7 milionë euro, që aktualisht tregon se transfertat private janë pak më të ulëta se sa pritej për tremujorin e parë sipas parashikimeve të tetorit.

Rezervat devizore bruto
(gjendja, në milionë euro)

*Të dhënat e fundit të disponueshme: 28.02.2025

Burimi: BPRMV.

Rezervat valutore bruto në fund të shkurtit 2025 arritën në 4.861,3 milionë euro dhe shënuan një rënie krahasuar me fundin e vitit 2024, e cila vjen si pasojë e transaksioneve për llogari të shtetit¹⁶, si dhe rezultat i transaksioneve të administrimit të rezervës valutore.


Faktorët e ndryshimit të rezervave devizore në janar - shkurt 2025
(në milionë euro)

Burimi: BPRMV.

¹⁶Më 20 janar 2025, Ministria e Financave ka bërë një pagesë për eurobondin e emetuar në vitin 2018 në shumë prej 500 milionë euro, pas një huamarrjeje të mëparshme në të njëjtin muaj dhe për të njëjtën shumë nga banka hungareze EXIM. Megjithatë, në periudhën janar-shkurt 2025 u realizuan pagesa të kryegjësë dhe interesa drejt më shumë institucioneve ndërkombëtare në bazë të huamarrjes së huaj.

SEKTORI I JASHTËM

Tregu valutor
(në milionë euro)




*Të dhënat e fundit të disponueshme: 28.02.2025
Burimi: BPRMV.

♦ Neto blerje/shitje të valutave (boshti djathtas)

Në periudhën janar - shkurt 2025, tregu i këmbimit valutor të bankave regjistroi një shitje neto më të ulët të valutës krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në kushtet e rritjes më të fortë të ofertës në raport me rritjen e kërkesës për valutë...

Struktura e tregut valutor
(shitje/blerje neto, në milionë euro)




*Të dhënat e fundit të disponueshme: 28.02.2025
Burimi: BPRMV.


...lëvizje të tilla në tregun valutor vijnë si rezultat i uljes së shitjeve neto të kompanive në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa njëkohësisht edhe rritjes së blerjeve neto nga individët.

Instrumentet monetare

(gjendja në fund të muajit, në milionë denarë)



(gjendja në fund të vitit, në milionë denarë)




Burimi: BPRMV

Gjendja e instrumenteve monetare në janar 2025 shënoi rritje krahasuar me fundin e dhjetorit të vitit të kaluar, për shkak të rritjes së sasisë së mjeteve të bankave të vendosura në depozita në dispozicion në Bankën Popullore.

Niveli i instrumenteve monetare në fund të muajit janar është më i lartë krahasuar me nivelin e parashikuar në fund të tremujorit të parë të vitit 2025, me mjete neto valutore më të larta të Bankës Popullore dhe depozita pak më të larta të qeverisë, krahasuar me nivelet e parashikuara.

Ecuria e parasë primare në fund të janarit 2025 është nën vlerat e parashikuara, krahasuar me parashikimet e tetorit.




* Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozitat e institucioneve të tjera financiare, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive tek bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve të

Pas rritjes së lartë në muajin paraardhës, **totali i depozitave¹⁷ në sistemin financiar** shënoi një ndryshim në rënie në janar 2025 prej 1,2%, që është një lëvizje tipike për këtë periudhë. Rënia vjen si pasojë e rënies së depozitave të korporatave, në kushtet e rritjes së ulët të amvisërive dhe sektorëve të tjerë. Nga **këndvështrimi valutor**, ka një rënie si në depozitat valutore ashtu edhe në ato në valutë vendase (me para depozite).

Totali i depozitave në janar 2025 shënoi rënie krahasuar me fundin e dhjetorit 2024, që aktualisht është mbi rënieën e pritshme për tremujorin e parë të 2025, sipas parashikimit të tetorit.

Norma vjetore e rritjes së totalit të depozitave në janar 2025 është 10% dhe aktualisht është mbi normën e parashikuar për tremujorin e parë të 2025 prej 8,0%, sipas projeksionit të tetorit.




Në janar 2025, ka pasur një rritje të vogël mujore të **depozitave të amvisërive**, e ndikuar nga rritja e moderuar e depozitave në valutë në kushtet e stagnimit të depozitave në monedhë vendase (me para depozite). **Në bazë vjetore, depozitat e amvisërive në janar 2025 janë më të larta për 14,2%.**

Burimi: BPRMV.


¹⁷ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetëror të bankave dhe kursimoreve, mjeteve të institucioneve tjera financiare në llogaritë të BPRMV-ja dhe mejetet e njësisë të vetëqeverisjes lokale në llogaritë të BPRMV-ja. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

Depozitat në denarë dhe në devizë /totali i depozitave të individëve

(pjesëmarrja në fund të muajit, në %)



(pjesëmarrja në fund të vitit, në %)



— Pjesëmarrja e depozitave në denarë (me para të depozituara) të individëve në totalin e depozitave të individëve
 — Pjesëmarrja e depozitave në valutë të huaj (me denarë në klauzulë valutore) të individëve në totalin e depozitave të individëve


* Totali i depozitave vetëm tek bankat dhe kursimoret.

Burimi: BPRMV


Respektivisht, të lehta janë ndryshimet edhe në strukturën valutore të depozitave totale të amvisërive në janar të vitit 2025.

Paraja e gjerë M4

(kontributet në p.p., ndryshime mujore)



(kontributet në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, në janar 2025, shënoi një rënie prej 1,3%, e cila nga pikëpamja e maturimit rrjedh nga kontributi negativ i pothuajse të gjithë komponentëve, me përjashtim të rritjes së vogël të depozitave afatgjata, ndërsa nga këndvështrimi valutore, të dy komponentët shënuan një kontribut negativ.


Në nivel vjetor, paraja e gjerë në janar 2025 shënoi rritje prej 10,4%, që është mbi rritjen e pritur vjetore prej 8,0% për tremujorin e parë të vitit, sipas parashikimit të tetorit.

Pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në denarë në totalin e M4

(të dhënat në fund të muajit, në %)



(të dhënat në fund të vitit, në %)




Burimi: BPRMV


Pjesëmarrja e pjesës së denarit në paranë e gjerë të përgjithshme M4 në janar 2025, është pothuajse e pandryshuar nga muaji i kaluar dhe është mbi vlerën e parashikuar.

Gjithsej kreditë

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



■ Kreditë në deviza
■ Kreditë në denarë
■ Kreditë e ndërmarrjeve
■ Kreditë e individëve
■ Kreditë, ndryshimet mujore/vjetore, në %


Burimi: BPRMV.

Totali i kredive në janar 2025 shënoi rënie minimale mujore prej 0,1%, që është dukuri e zakonshme për këtë muaj të vitit.

Në janar, totali i kredive shënoi rënie të lehtë krahasuar me fundin e dhjetorit 2024, me rritje të pritshme për tremujorin e parë të vitit 2025, sipas parashikimeve të tetorit.


Norma vjetore e rritjes së totalit të kredisë në janar shënon 11,3%, dhe është mbi rritjen e parashikuar vjetore prej 7,5% për tremujorin e parë të 2025, sipas parashikimit të tetorit.

Kredi të reja të sektorit privat, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes




Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, duke përfshirë janarin e vitit 2025, ka ardhur duke u rritur me ritme më të ngadalta në bazë vjetore.

Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes



Kredi të reja të amvisërive, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes



Raporti ndërmejt kredive dhe depozitave totale (të dhënat mujore, në %)




Treguesi i shfrytëzimit të potencialit depozitues të bankave për kreditimin e sektorit privat në muajin janar ishte 82,4%, që është pothuajse në nivelin e vlerës së parashikuar të këtij treguesi për fund të tremujorit të parë 2025, sipas parashikimit të tetorit.

(të dhënat vjetore, në %)



Burimi: BPRMV


Normat e interesit të gjithsej depozitave
(të dhëna mujore, në %)



Burimi: BPRMV

Në janar 2025, **norma e interesit në totalin e depozitave valutore**¹⁸ ka shënuar lëvizje lehtësisht në rënie në krahasim me muajin paraprak, ndërsa norma e interesit **në totalin e depozitave në denarë** nuk ka ndryshuar, gjë që ka ndikuar në ndryshim të vogël në rritje të diferencës së interesit prej 0,1 p.p. Normat e interesit për **depozitat e reja në denarë dhe për depozitat e reja valutore**¹⁹ shënuan një lëvizje më të theksuar rënse, por pa ndikim në diferencën e normës së interesit, e cila mbeti në nivelin e muajit të kaluar...

Normat e interesit të depozitave të individëve
(të dhëna mujore, në %)




Burimi: BPRMV

...lëvizje identike në janar 2025 vërehen edhe te normat përkatëse të interesit te totali i depozitave të **sektorit "amvisëri"**.


¹⁸ Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

¹⁹ Për sa i përket normave të interesit të depozitave të reja, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë) dhe norma e tyre e interesit.

Normat e interesit të gjithsej kredive, sipas sektorëve
(të dhëna mujore, në %)




(të dhëna vjetore në fund të vitit, në %)



— Norma e interesit të kredive të individëve
— Norma e interesit të kredive të ndërmarrjeve

Burimi: BPRMV.

Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në %) dhe
diferenca e tyre (në p.p.)




Në janar 2025, një lëvizje e lehtë në rënie është vërejtur edhe në normat e interesit për **kreditë totale të korporatave**, ndërkohë që normat e interesit për **amvisëritë** kanë mbetur të pandryshuara, ndërsa normat e interesit për **kreditë e reja**²⁰ të miratuara për korporatat dhe amvisëritë janë rritur në krahasim me muajin paraardhës.

Në shkurt 2025, diferenca e normave bazë të interesit të Bankës Popullore dhe Bankës Qendrore Europiane (BQE) u zgjerua lehtë (me 0,05 p.p.) si pasojë e uljes më të ulët prej 0,20 p.p. me normën bazë të interesit nga Banka Popullore.


²⁰ Për sa i përket normave të interesit për kreditë e reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë) dhe norma e tyre e interesit.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore (kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)



Në janar 2025, të hyrat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) shënuan rritje vjetore, me rritje të moderuar në të gjitha kategoritë e të hyrave buxhetore. Shpenzimet buxhetore shënuan rënie të lehtë në bazë vjetore, si pasojë e rënies së shpenzimeve kapitale dhe ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve aktuale.²¹

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive, (Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor



...deficiti buxhetor i realizuar në vlerë prej 2.706 milionë denarë paraqet 6,5% të deficitit të planifikuar për vitin në pajtim me Buxhetin.²²...



Burimi: Ministria e Financave dhe Illogaritjet e BPRMV-së.

²¹ Pjesërisht si pasojë e rritjes së bazës së krahasimit, e ndikuar nga rritja e transfertave drejt kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve si pjesë e paketave të masave kundër krizës.

²² "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 254 nga 16.12.2024.

Financimi i bilancit buxhetor

(në milionë denarë)




* Ndryshimi pozitiv: ulje e depozitave tek BPRMV, ndryshimi negativ: rritje e depozitave tek BPRMV.

Burimi: Ministria e Financave.

...i njehti financohet nga huamarrja neto e shtetit në tregun e brendshëm dhe nga një konsum i vogël depozitash, me zhvlerësim neto në tregun e jashtëm²³.

Normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Në janar 2025, në ankande të rregullta, u emetuan bono thesari dymbëdhjetëmujore, bono thesari me normë interesi të pandryshuar prej 3,8% si dhe obligacione qeveritare trevjeçare, obligacione qeveritare pesëvjeçare dhe obligacione qeveritare pesëmbëdhjetëvjeçare pa klauzolë valutore, me norma më të ulta të interesit prej 3,65%, 3,9% dhe 5,1%, respektivisht.

²³Më 20.01.2025, Ministria e Financave ka bërë një pagesë për eurobondin e emetuar në vitin 2018 në shumën prej 500 milionë euro (me afat maturimi 7 vjet dhe normë vjetore interesi 2,75%), pas një huamarrjeje të mëparshme në të njëjtin muaj për të njëjtën shumë nga banka hungareze EKSIM, me një periudhë shlyerjeje 15 vjeçare, duke përfshirë një periudhë mospagimi prej 3 vjetësh dhe një normë interesi prej 3,25%. Gjithashtu, në janar 2025 u realizuan pagesa për kryeqj dhe interesa në institucione ndërkombëtare në bazë të huamarrjes së huaj.

Shtojca 1: Kategoritë treguese të konsumit personal dhe investimeve bruto

KATEGORITË INDIKATIVE PËR KONSUMIN PRIVAT													
	2022				2023				2024				2025
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	
	ndryshime reale vjetore në %												
Qarkullimi në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-0.4	-1.4
Të ardhurat bruto nga TVSh-ja*	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	1.6	5.5	4.5	0.2	-2.1
Importi i mallrave për konsum të gjërë*	-2.8	-1.5	-2.1	-9.9	2.0	4.7	1.4	14.5	15.4	4.2	8.6	0.3	2.1
Prodhimi vendor i mallrave të konsumit	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-8.5	-7.1	5.4	1.3	13.1
Kreditë konsumatore*	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	2.9	3.9	5.1	4.3	3.8
Paga mesatare neto*	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	12.5	9.6	9.0	4.7	-
Transferrat private neto*	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.4	-11.9	-11.3	-5.7	-6.1	-
Pensionet*	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	17.0	10.1	9.5	13.0	7.0

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET													
	2022				2023				2024				2025
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	
	ndryshimet reale vjetore në %, përveç IHD-ve ku ndryshimet reale janë në milionë denarë												
Importi i mjeteve për punë*	6.9	5.6	10.9	-1.3	-3.9	-1.9	-5.5	3.0	10.9	3.4	-1.8	-1.4	-11.6
Punë ndërtimore të realizuara**	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	27.2	-
Prodhimi vendor i produkteve kapitale	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	10.6	-2.8	0.9	-9.9	-19.4
Investime kapitale shtetërore*	-16.4	25.0	-47.3	55.6	-6.8	313.0	29.1	-4.0	27.5	-65.8	-25.8	-31.1	-85.3
Investime të huaja direkte***	9952.1	-6570.3	10995.8	271.5	256.3	-2275.1	-9575.7	-2500.5	8987.8	5770.4	11973.9	8992.4	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	2.8	4.8	5.8	9.4	8.9
Stoqet e produkteve të gatshme	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	2.0	4.5	1.0	-0.1	-

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.
** normat reale të rritjes janë fituar duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve për ndërtimin e banesave të reja.
*** vlerat reale janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar vlerat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2024= 100).
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.